



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Opština Klokot/Komuna e Kllokot/ Municipality of Klokot

Datë : 31/08/2020 .

Në bazë të nenit 12. nenit: 17. Pika (c, h); Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03 / L-040, si dhe Statuti i Komunës Neni 8 Pika (c, h) Asambleja Komunale në seancën e tetë të rregullt miraton:

VENDIMIN

**MBI DHËNJEN E PËLQIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS NË
NGASTRËN NR: 957-5 PËR NXËNËSIT E KOMUNITETIT SHQIPTAR TË MOSHËS NGA 0 DERI NË
KLASËN E 9**

Neni 1.

Në seancën e tetë të rregullt të mbajtur më 31 gusht 2020, Kuvendi Komunal miratoi vendimin për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e një shkolle në ngastrën komunale nr 957-5 për nxënësit e komunitetit shqiptar të moshës 0 deri në klasën e 9.

Neni 2.

Propozim-vendim i drejtorit të departamentit të arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, kulturës, rinisë dhe sportit numër: 878/1 datë: 24.08.2020, i cili u iniciua nga qytetarët, nënshkrues të kërkesës në formën e një peticioni për të përmbushur nevojat e nxënësve të shkollës fillore Komunitetit shqiptar të moshës (0- zero) deri në klasën e (9-nëntë), për të cilat komuna aktualisht ofron shërbime të transportit nga Kllokoti në Pozharan. Këshilltarët e Asamblesë Komunale u deklaruan duke votuar si më poshtë: 10 këshilltarë votuan PRO; KUNDËR: nuk pati; ABSTENIME : nuk kishte. Kurse nuk morën pjesë në votim 5 delegatë. Konstatohet se vendimi nga neni 1. I këtij vendimi u miratua me 10 vota, gjegjësisht me shumicën e votimit të delegatëve të Asamblesë komunale në përbërjen e tyre prej 15. Vendimi është marrë në interes publik për të gjetur fonde, si dhe për të zbatuar procedurën ligjore për ndërtimin e një shkolle të re në ngastrën komunale nr: 957-5 në zonën kadastrale Kllokot, zona e së cilës është 1500 m2 e cila ndodhet në rrethin e Banjës së vjetër në Kllokot.

Vendimi u mor për gjeneratat e ardhshme të nxënësve në mënyrë që të hapet mundësia që nxënësit të cilët aktualisht po udhëtojnë në komunën fqinje të Vitis-Pozharan të arsimohen, është e nevojshme të mundësohet shkollimi në komunën e Kllokotit-Kllokot ku ata jetojnë. Gjithashtu, ofrimi i një mundësie për të hapur klasa shtesë të nxënësve dhe për të zgjidhur problemin e arsimit të komunitetit shqiptar në teritorin e komunës, dhe me vetëfaktin tu ofrohet siguri adekuate për fëmijët në çdo segment.

Neni 3.

Për implementimin e këtij vendimi do të kujdeset:

- Kryetari i komunës;
- Departamenti i Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimeve Sociale, Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Departamenti i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, në zbatimin e procedurave ligjore.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Asamblesë Komunale dhe vlerësimin e ministrisë kompetente për vetëqeverisjen lokale. Vendimi të publikohet në faqen e internetit të faqes komunale.

Dorëzohet :

- Kabinetit kryetarit
- Asamblesë komunale
- Departamenti i Arsimit, Shëndetësisë,
Shërbimeve Soc.
Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Departamenti i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit
- Arkivës

Kryesuesi i Asamblesë komunale
Kllokot


/ Žarko Dejanović/